

21-22
FL

RUBRIKA I
TESTI I INTELIGJENCES
TEZA 1

1. Cili është numri që mungon në këtë seri numrash: 16, 8, 32, 16, ?, 32, 128

- a) 64 b) 80 c) 96 d) 72

2. Çfarë zbuloi Röntgen?

- a) Moshë e Diellit
b) Rrezet UV
c) Rrezet X
d) Teleportimi

3. Fakulteti i drejtësisë së një universiteti ka porositur një kuti me libra juridikë nga SHBA. Literatura juridike vjen me det në një kontener me anije transporti. Konteneri është i vendosur mbi kuvertën e anijes. Bibliografi hap kutinë e librave juridikë dhe zbulon se disa prej tyre janë lagur. Ajo më pas i numëron ato në mënyrë që të bëjë ankim zyrtar dhe zbulon se 68 libra janë të lagur, sasi që përbën 16 për qind e të gjithë përmbajtjes së kutisë. Sa libra juridikë kishte kutia?

- a) 476
b) 425
c) 336
d) 340

4. Kryeqytet i cilit shtet është Beirut?

- a) Mozambik
b) Serbi
c) Liban
d) Laos

5. Cili numër duhet të pasojë në këtë seri numrash "7, 12, 24, 29, 58, ?"

- a) 48 b) 34 c) 45 d) 63

6. Nëntë numrat në anën e majtë të tabelës lidhen me njëri tjetrin në një mënyrë të caktuar. Gjeni sesi funksionojnë këto nëntë numra në anën e majtë të tabelës. Nëntë numrat në anën e djathtë të tabelës funksionojnë ekzaktësisht në të njëjtën mënyrë. Cili numër duhet të zëvendësojë pikëpyetjen?

5	6	1		7	8	1
4	6	2		4	7	3
9	9	0		0	?	4

- a) 6 b) 3 c) 7 d) 4

L



7. Cilit prej presidentëve amerikanë i dedikohet heqja e skllavërisë?

- a) Uashington
- b) Linkoln
- c) Xheferson
- d) Adams

8. Një tren hyn në një tunel që është 25 km i gjatë dhe udhëton me shpejtësi 80 km/orë. Gjatësia e trenit është 500m. Sa kohë i duhet të gjithë gjatësisë së trenit të kalojë nëpër tunel nga momenti që fillon futet, deri në daljen e fundit të trenit?


- a) 2 min 15 sek
- b) 2 min 30 sek
- c) 3 min
- d) 2 min 25 sek

9. Babai i Merit ka 5 vajza: 1. Nana, 2. Nene, 3. Nini, 4. Nono, por cili është emri i vajzës së pestë?

- a) Nunu
- b) Nonu
- c) Ninu
- d) Meri

10. Cili numër duhet të pasoj në këtë seri numrash?: 96, 52, 44, 41, 23, 18, 67, 52, ...

- a) 17;
- b) 27;
- c) 15;
- d) 35



RUBRIKA II
LEGJISLACIONI I BE, MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE,
E DREJTË E KRAHASUAR DHE HISTORI

TEZA 14

LEGJISLACIONI I BE

11. Institucioni që përfaqëson Bashkimin mbikombëtar në BE është:
- Komisioni
 - Këshilli i Ministrave
 - Parlamenti Europian
 - Gjykata Europiane e Drejtësisë.
12. Efekti i drejtpërdrejtë i zbatimit të së drejtës komunitare sipas GJED nënkupton që:
- Shtetet nuk mund të nxjerrin masa të mëtejshme zbatimi pas daljes së një akti ligjor komunitar
 - Shtetet nuk mund të nxjerrin masa të brendshme zbatimi me të njëjtën përmbajtje për t'i dhënë efekt një akti ligjor komunitar
 - Nene të caktuara të Traktatit të BE mund t'i japin të drejta subjektive individëve, të cilat këta i mbrojnë para gjykatave kombëtare
 - E drejta e BE ka epërsi mbi të drejtën e shteteve anëtare.
13. Në cilën çështje GJED është shprehur mbi supremacinë e ligjit komunitar në ligjin e brendshëm se *"Shtetet nuk mund të miratojnë legjislacion të brendshëm të mëtejshëm që bie në kundërshtim me të drejtën komunitare."*:
- Costa k. Enel
 - Van Gend en Loos
 - Simmenthal
 - Francovich.

E DREJTË NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

14. Vija bazë normale ndjek:
- Pikat më të dala të tokës në det
 - Vijën normale të bregdetit
 - Vijën e zbatueshme më të madhe.
15. Autoriteti Ndërkombëtar i Fundit të Detit kontrollon:
- Shfrytëzimin e Shelfit Kontinental
 - Shfrytëzimin e Zonës
 - Shfrytëzimin e Zonës Ekonomike Ekskluzive.
16. Rangjet e konsujve janë:
- 1) Konsuj profesionistë 2) Konsuj karriere
 - 1) Konsull i Përgjithshëm 2) Ministër Fuqiptotë 3) Konsull 4) Agjent konsullor.
 - 1) Konsull i Përgjithshëm 2) Konsull 3) Nënkonsull 4) Agjent konsullor.



RUBRIKA II
LEGJISLACIONI I BE, MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE,
E DREJTË E KRAHASUAR DHE HISTORI

E DREJTË E KRAHASUAR

17. Sipas Traktatit Lateran:

- a. Feja dhe shteti ishin të lidhura ngushtë;
- b. Feja katolike është feja e vetme e shtetit;
- c. Feja dhe shteti nuk kanë asnjë lidhje me njëra tjetrën;
- d. A dhe b.

18. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë në Angli emërohen nga Mbretëresha me propozim të Ministrit të Shtetit:

- a. E vërtetë
- b. E gabuar.

HISTORI

19. Parimi i ndarjes dhe i pavarësisë së pushteteve, për herë të parë në botë është sanksionuar nga:

- a. Kushtetuta e viti 1795 në Francë;
- b. Kushtetuta e SHBA;
- c. Kushtetuta e Vajmarit;
- d. Kushtetuta e Republikës V në Francë

20. Sistemi federativ i vendosur nga Kushtetuta e SHBA karakterizohet:

- a. Nga autonomia e lendeve të veçanta;
- b. Nga centralizimi i rreptë i pushtetit qendror;
- c. Nga garantimi i autonomisë dhe vetqeverisjes së shteteve të veçanta;
- d. Nga b dhe c.



RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

TEZA 9

21 Qarkoni me se është shprehur kryefjala në fjalinë e dhënë: “ Tani trëndafili do të na mbushë kopshin plot aromë të këndshme”

- A) Emër; B) Grup emëror; C) Mbiemër; D) Përemër.

22 Qarkoni fjalinë e përbërë:

- A) Ferra dhe trëndafili jetonin pranë njeri-tjetrit.
B) Ferra rritej me gjembat e saj, kurse trëndafili lëshonte gonxhe.
C) Një ditë prej ditësh pranë tyre u afrua kosëtari.
D) Fletët e mia janë krejt ndryshe nga fletët e tua, moj ferrë !

23 Fjala “ gjithçka” është :

- A) E thjeshtë; B) E përbërë; C) E prejardhur; D) E përngjitur.

24 Përcaktoni klasën e fjalës së nënvizuar në fjalinë: “ Butë- butë, heshtja përpiu gjithçka”:

- A) Ndajfolje mënyre;
B) Ndajfolje sasi;
C) Ndajfolje kohe;
D) Ndajfolje vendi.

25 Qarkoni se ç’lloj fjalie është pjesa e nënrenditur e fjalës : “ Kur pushimet po mbaronin, ne të gjithë sikur po shkallonim”:

- A) Qëllimore;
B) Shkakore;
C) Rrjedhimore;
D) Kohore.

26 Në tekstet e mëposhtme gjeni cila nga alternativat është shprehur saktë:

1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohen nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale;
2. Organizata Kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohen nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale.

- A) Alternativa e parë;
B) Alternativa e dytë;
C) Të dyja alternativat.



RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

27 Në tekstin e mëposhtëm dalloni në sa prej fjalëve zanorja “ë” mungon apo është shtuar:

“Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, shërbimi i provës i raporton menjëher prokurorit”

- A) 1 fjalë; B) 2 fjalë; C) 3 fjalë; D) 4 fjalë.

28 Fjalët: *i zhdrejtë, ripërdor, i paparë*, janë formuar me:

- A) Prapashtesë; B) Parashtesë; C) Përngjitje; D) Përbërje.

29 Cili është funksioni i paskajores në fjalinë: “ - E kur ndodhi kjo? - e pyeta, më shumë për të kuptuar se çfarë po ndodhte.”:

- A) Rrethanor mënyre;
B) Rrethanor qëllimi;
C) Rrethanor shkaku;
D) Rrethanor vendi.

30 Përcaktoni llojin e përemrit të nënvizuar në fjalinë: “ Nuk ndodhi aspak për fajin tënd!”:

- A) Përemër pronor;
B) Përemër vetor;
C) Përemër dëftor;
D) Përemër i pacaktuar.

31 Gjeni funksionin sintaksor të fjalës së nënvizuar në fjalinë: “ Ai dinte gjithçka dhe ishte i gatshëm të më shpjegonte gjithçka.”:

- A) Përcaktor;
B) Kundrinor i drejtë;
C) Kundrinor i zhdrejtë;
D) Kundrinor i zhdrejtë me parafjalë.

32 Cila nga grupet e fjalëve është shprehje frazeologjike?

- A) Mendova se ishte e pazonja;
B) Vdekur nga të ftohtët;
C) Ishte sa për sy e faqe;
D) Plakë me flokë të bardha.

33 Në cilin rast përemri pyetës është përdorur gabim?

- A) Cilin libër po lexon?
B) Cilin po lexon?



RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

- C) Çfarë po lexon?
- D) Kë libër po lexon?

34. Cili grup emëror është shqip?

- A) Shef programacioni;
- B) Përgjegjës programacioni;
- C) Shef programimi;
- D) Përgjegjës programimi.

35. Forma e pashtjelluar e foljes “për të mësuar” është:

- A) Paskajore; B) Përcjellore; C) Mohore; D) Pjesore.

36. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “Buzë lumit kalonte rruga automobilistike.” është:

- A) Ndajfolje vendi;
- B) Emër në kallëzore;
- C) Emër në emërore;
- D) Parafjalë.

37. Fjalëza “tek” në fjalinë: “E gjeti tek po bënte stërvitje në palestër” është:

- A) Parafjalë; B) Lidhëz; C) Ndajfolje; D) Pjesëz.

38. Çiftet e fjalëve: *errësirë-dritë; dashuri-urrejtje; flet-hesht*, janë:

- A) Sinonime; B) Antonime; C) Homonime; D) Idioma.

39. Cila folje është në mënyrën habitore?

- A) Do të çuditesha;
- B) Mendohuni;
- C) Pastë pësuar;
- D) U afruakësh.

40. Cilat janë fjalë të ndryshueshme?

- A) Parafjalët;
- B) Numërorët;
- C) Lidhëzat;
- D) Ndajfoljet.



RUBRIKA IV
PSIKOLOGJI - KOMUNIKIM

TEZA 13

41) Kushtëzimi klasik i drejtimit bihejviorist, pohon se:

- a. forcat e brendshme motivojnë sjelljen
- b. tiparet e intraversionit dhe ekstraversionit janë përgjegjëse për sjelljen
- c. sjellja është e pandryshueshme
- d. sjellja mësohet ndërmejt ndërveprimit me mjedisin

42) Cili nga pohimet është i vërtetë mbi inteligjencën:

- a. Individët me inteligjencë të ulët kryejnë vepra kriminale
- b. nuk ka asnjë lidhje mes veprave kriminale dhe inteligjencës
- c. personat me inteligjencë më të ulët prirën që ta pranojnë fajin
- d. individët me inteligjencë më të lartë kryejnë më shumë vepra kriminale

43) Teoria e Gluecks pohon se:

- a. ka një lidhje mes personalitetit dhe sjelljes agresive
- b. personat që shfaqin sjellje kriminale janë introvertë dhe të tërhequr
- c. personat që prirën drej sjelljeve kriminale kanë nivele të larta testosteroni
- d. asnjë nga këto

44) Teoria sociale e të mësuarit e shpjegon agresivitetin:

- a. sipas konflikteve të pandërgjegjshme
- b. bazuar në fantazinë dhe imagjinatën
- c. sipas modelit të ndëshkimit dhe shpërblimit sjellor
- d. të gjitha më sipër

45) Afilacioni ka të bëjë me:

- a. aspektet biologjike të individit
- b. nevojën e përkatësisë
- c. ekzaminimin mjekësor të individit
- d. raportimet nga dëshmitarët



RUBRIKA IV
PSIKOLOGJI - KOMUNIKIM

TEZA 13

46. Rikrijimi i fytyrës së viktimës nga antropologët, realizohet:

- a. duke pyetur dëshmitarët okular
- b. duke u bazuar në përvojën e tyre të mëparshme
- c. nga gërmimet arkeologjike
- d. asnjë nga këto

47. Entomologjia ligjore mund të përdoret me fëmijët:

- a. për të identifikuar nëse ata janë fajtorë për një ngjarje të caktuar
- b. për të vërtetuar dëshminë që japin
- c. si metodë alternative vlerësimi
- d. për të hulumtuar abuzimin ose neglizhimin me pasojë vdekje

48. Në hapat e parë, biometrika zhvilloi teknikën e :

- a. identifikimit të shenjave të gishtave
- b. verifikimin e zërit
- c. njohjen e zërit
- d. verifikimin e firmës

49. Poligrafi:

- a. është instrument që nuk mund të manipulohet
- b. është lehtësisht i përdorshëm edhe nga joekspertë
- c. përmban pyetje që lidhen me emocionet, por jo me krimin
- d. përmban pyetje që lidhen vetëm me krimin

50. Teoria psikonalitike e shpejgon sjelljen agresive:

- a. si shfaqje të instiktit të jetës
- b. e lidhur me problemet e hershme atashuese me nënën
- c. nëpërmjet ndikimit të vetëdijes tek individi
- d. të gjitha më sipër



RUBRIKA V
ETIKA PROFESIONALE

TEZA 9

- 51) Policia iu jep prova që mund të jenë marrë gjatë një kontrolli të paligjshëm. Sipas Kodit të Etikës:
- Ju duhet të përpiqeni të përcaktoni nëse provat u morën në mënyrë të paligjshme;
 - Ju duhet të refuzoni përdorimin e provave nëse besoni se janë marrë në mënyrë të paligjshme;
 - Nëse zbuloni se provat u morën në mënyrë të paligjshme, duhet të garantoni se do të ndërmerren veprimet e duhura kundër atyre që mblodhën provat;
 - Të gjithë të mësipërmet.
- 52) Avokati X po përfaqëson një klient në një çështje të vështirë për kujdestarinë e një fëmije. Gjatë një seance përgatitore, gjyqtari i përmend klientit se bazuar mbi një përmbledhje të fakteve të padisë, nuk ka shumë gjasa që ai të fitojë kujdestarinë e fëmijës së tij. Në një takim me klientin në zyrën e Avokatit X, klienti i përmend Avokatit se ai i konsideron deklaratat e gjyqtarit të papranueshme, dhe se në seancën e ardhshme, ai ka për qëllim t'i thotë gjyqtarit se ai është "dukshëm i korruptuar". Cila prej thënieve të mëposhtme është e saktë?
- Avokati X ka një detyrim, në këto rrethana, të këshillojë klientin e tij që të mos bëjë deklaratat të tilla dhe të tregojë respekt ndaj gjykatës.
 - Avokati X është i detyruar, në këto rrethana, të tërhiqet nga përfaqësimi i klientit.
 - Avokati X nuk duhet të ndërhyjë në qëllimet e klientit të tij meqenëse gjyqtari e ka shkelur detyrimin e tij etik për të vepruar drejtë me palët dhe për të qëndruar i paanshëm.
 - Avokati X nuk duhet të ndërhyjë në qëllimet e klientit të tij, duke marrë parasysh detyrimet e tij profesionale për t'i shërbyer klientëve të tij me besnikëri përgjatë procesit gjyqësor.
 - Asnjëra prej thënieve të mësipërme nuk është e saktë.
- 53) Cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë:
- Pavarësia duhet të ketë përparësi kundrejt llogaridhënies së prokurorisë;
 - Llogaridhënia duhet të ketë përparësi kundrejt pavarësisë së prokurorisë.
 - Pavarësia e prokurorisë dhe llogaridhënia duhet të jenë të balancuara;
 - Pavarësia dhe llogaridhënia janë çështje për gjyqtarët dhe jo për prokurorët.
- 54) Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Prokurorët parashikojnë se një prokuror duhet:
- T'i rezistojë të gjitha përpjekjeve për devijimin e çështjeve penale nga sistemi formal i drejtësisë;
 - Të eksplorojë mundësinë e përdorimit të skemave të devijimit;
 - Të kërkojë dënime me burg në të gjitha rastet;
 - Të bjerë dakord për devijimin e çështjeve vetëm në rastet që kanë të bëjnë me të sëmurë dhe të mitur.
- 55) Cili dokument përmban një dispozitë që i kërkon prokurore të raportojnë shkeljen e të drejtës penale nga një prokuror tjetër:
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara;



RUBRIKA V
ETIKA PROFESIONALE

- b) Kodi Shqiptar i Etikës për Prokurorët;
c) Kodi Penal Shqiptar;
d) Të gjitha të mësipërmet.
- 56) Një biznesmen iu jep një makinë të mirë për ta ngarë. Ai thotë se po ua jep hua, dhe se ju nuk duhet të paguani ndonjë për përdorimin e saj. Ai iu thotë se do t'ua kërkojë nëse do t'i lindë ndonjëherë nevoja. Deri atëherë, ju mund ta ngisni sepse tregon respektin që duhet të ketë zyra juaj.
- a) Ju mund ta pranoni makinën, por vetëm nëse biznesmeni nuk ka asnjë interes në çështjet që po hetoni;
b) Ju mund ta pranoni makinën, por vetëm nëse biznesmeni nuk ka asnjë interes në asnjë çështje pezull në zyrën tuaj;
c) Ju mund ta pranoni makinën nëse vlera e saj i kalon 5,000 Euro;
d) Ju nuk mund ta pranoni makinën.
- 57) Një koleg i juaji në zyrë mban një shishe të hapur rakie në tryezë dhe pi nga ajo gjatë ditës së punës.
- a) Nuk ka nevojë të ndërmerret ndonjë veprim nga ana juaj nëse alkoli nuk ndikon në punën e kolegut tuaj;
b) Nuk ka nevojë të ndërmerret ndonjë veprim nga ju nëse alkoli është prodhuar ligjërisht dhe të gjitha taksat janë të paguara;
c) Ju duhet ta raportoni këtë tek Inspektori i Etikës, por më parë duhet t'i sugjeroni kolegut tuaj që ta raportojë këtë gjendje vetë;
d) Ju duhet ta raportoni këtë çështje tek oficeri më i afërt i policisë gjyqësore.
- 58) Ju merrni informacion se avokati mbrojtës në mënyrë të pasaktë i ka thënë të pandehurit se nuk mund ta apelojë vendimin e gjykatës.
- a) Ju nuk duhet të ndërmerrni asnjë veprim, sepse i pandehuri përfaqësohet nga avokati.
b) Ju duhet të përpiqeni të korigjoni keqkuptimin duke informuar në mënyrë të saktë avokatin mbrojtës.
c) Ju duhet t'i sugjeroni të pandehurit që të marrë një avokat mbrojtës tjetër.
d) Ju duhet të apelonit në emër të të pandehurit.
- 59) Dëshmitari juaj kryesor në një gjykim ka dënime të mëparshme për mashtrim dhe vjedhje. Këto krime të kaluara nuk kanë asnjë lidhje me çështjen aktuale, e cila ka të bëjë me trafikimin e armëve të zjarrit. A i bëni të ditur këto dënime të mëparshme të dëshmitarit tuaj?
- a) Rregullat e etikës nuk iu kërkojnë të zbuloni dënimet e mëparshme që do të ishin të rëndësishme vetëm në rastin e vënies nën akuzë;
b) Rregullat e etikës nuk do t'ju kërkonin të zbulonit informacionin për dënimet e mëparshme sepse këto dënime nuk kanë asnjë lidhje direkte me krimin në akuzë.



RUBRIKA V
ETIKA PROFESIONALE

- c) Ju duhet t'i zbuloni dënimet e mëparshme sepse lidhen me besueshmërinë e dëshmitarit tuaj;
- d) Rregullat e etikës nuk lidhen me zbulimin e provave.
- 60) Avokati X është një avokat që sapo ka marrë licencën dhe sapo ka filluar punë në një zyrë ligjore në Sarandë. Më përpara, ai ka punuar në të njëjtën zyrë ligjore si stazhier nën mbikëqyrjen e Avokati Y, një avokat mbrojtës me përvojë në fushën penale. Gjatë javës së parë si avokat, Avokati X iu kërkua të përfaqësonte një autor të mitur të një vepre penale i cili akuzohet për posedim të substancave narkotike. Edhe pse Avokati X kishte shumë pak njohuri rreth kësaj fushe të ligjit dhe nuk kishte përvojë me mbrojtjen e klientëve të mitur, ai e mori përsipër çështjen. Kolegu dhe këshilluesi i tij, Avokati Y, e nxiti atë drejt një vendimi të tillë, duke i thënë se “përvoja është mënyra e vetme për të mësuar” dhe se në çdo rast, ai është i gatshëm të bashkëpunojë ngushtësisht me të gjatë kryerjes së kësaj detyre. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë?
- a) Avokati Y kishte detyrimin të trajtonte vetë çështjen përderisa ai e dinte se Avokati X nuk kishte kompetencën e nevojshme për të përfaqësuar autorin e mitur të veprës penale.
- b) Avokati Y bëri një shkelje etike duke i bërë presion Avokati X për të pranuar çështjen edhe pse Avokati X nuk kishte përvojën e nevojshme për të përfaqësuar klientin në mënyrën e duhur.
- c) Është e ndaluar që dy avokatë të punojnë së bashku për të njëjtën çështje sepse një gjë e tillë përbën konflikt interesi.
- d) Avokati X mund të pranojë çështjen, sepse pavarësisht se ai nuk ka kompetencën e nevojshme për të trajtuar çështjen, ai do të bashkëpunojë me një avokat që është kompetent.
- e) Përgjigjet A dhe B janë të dyja të sakta.



RUBRIKA VI

ADMINISTRATIVE - KUSHTETUESE

Teza 17

Gjeni pohimin e saktë

61 . Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është organ:

- a) që ushtron kontroll të përgjithshëm mbi administratën,
- b) i pavarur i administratës publike,
- c) punonjësit e të cilit nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

62 . Detyrat e Zëvendëskryeministrit përcaktohen:

- a) vetëm nga Kushtetuta,
- b) vetëm nga Ligji për organizimin dhe funksionim e administratës shtetërore,
- c) vetëm përmes akteve të ndryshme nënligjore të miratuara nga Kryeministri,
- d) nga ligje të veçanta, si dhe ato që i ngarkohen nga Këshilli i Ministrave ose nga Kryeministri.

63 . Ligji për nëpunësin civil përcakton si njësi përgjegjëse:

- a) Departamenti i Administratës Publike (DAP) për të gjithë shërbimin civil,
- b) Departamentin e Administratës Publike për institucionet e administratës shtetërore,
- c) Departamentin e Administratës Publike edhe për institucionet e pavarura,
- d) Departamentin e Administratës Publike edhe për njësitë e qeverisjes vendore.

64 . Lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative të shkallës së parë, për padi me objekt:

- a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi,
- b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi,
- c) kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të madhe se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

65 . Gjeni formulimin e gabuar

Vendimet e shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit dhe gjykata administrative e shkallës së parë mund të ankimohen me rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm kur:

- a) ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose është zbatuar keq,
- b) vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë,
- c) vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të Gjykatës Kushtetuese.



Teza 17

E DREJTA KUSHTETUESE

I. Rrethoni alternativën e saktë

66. . Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:
- Ligji për turizmin
 - Ligji për doganat
 - Ligji për amnistinë
67. . Kur vendi i Presidentit mbetet vakant, zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij:
- Kryeministri
 - Kryetari i Kuvendit
 - Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
68. . Rishikimi i Kushtetutës për të njëjtën çështje nuk mund të bëhet përpara se, nga dita e rrëzimit të projektligjit në referendum, të ketë kaluar:
- tre vjet
 - dy vjet
 - një vit
69. . Deputeti në ushtrim të funksionit nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura prej tij:
- me përfundim të rastit të fyerjes
 - me përjashtim të rastit të shpifjes
 - me përjashtim të rastit të fyerjes dhe shpifjes
70. . Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore sipas Kushtetutes mund të vendosen vetëm me:
- akt me fuqinë e ligjit
 - ligj të miratuar nga Kuvendi
 - dekret



Rubrika VII

Teza 19

E drejta Familjare

71. **Rretho përgjigjen e saktë: Prokurori mund të kundërshtojë lidhjen e martesës:**
- Për motive të njëjta si kujdestari;
 - Për të gjitha motivet e parashikura në Kodin e Familjes;
 - Për shkaqet që parashikohen në kodin e Familjes, për të cilat ai mund të kërkojë pavlefshmërinë e saj;
 - Në të gjitha rastet më sipër.
72. **Rretho përgjigjen e saktë: Qëpasuria të jetë pasuri e përdorimit ngushtësisht vetjak të njërit bashkëshort:**
- Mjafton që të përdoret eskuzivisht vetëm nga ky bashkëshort;
 - Nëse përdoret nga bashkëshorti, ndërkohë që qëllimi nuk ka qenë përdorimi personal;
 - Nëse përdoret eskuzivisht dhe në mënyrë vetjake nga bashkëshorti, edhe pse destinacioni i sendit nuk e përjashton përdorimin edhe nga bashkëshorti tjetër;
 - Nëse është destinuar dhe përdoret eskuzivisht nga ky bashkëshort
73. **Është e vërtetë se: I mituri që për shkaqe me rëndësi lejohet nga gjykata të lidhë martesë nën moshë:**
- Ka si regjim pasuror atë të pasurive të ndara;
 - Ka si regjim pasuror atë të bashkësisë ligjore;
 - Ka si regjim pasuror atë të bashkësisë me kontratë;
 - Ka të drejtë të zgjedhë regjimin më të përshtatshëm për të.
74. **Rretho përgjigjen e gabuar.**
- Njohja e fëmijës mund të bëhet edhe nga nena e mitur.
 - Njohja e fëmijës kur nëna është e mitur bëhet nëpërmjet kujdestarit.
 - Njohja e fëmijës mund të bëhet vetëm nga babai që ka mbushur 18 vjeç.
 - Njohja e fëmijës mund të bëhet nga nëna në rastet kur në aktin e lindjes mungon amësia.



RUBRIKA VII

TEZA 19

E DREJTË TREGTARE

75. Në sistemin me një nivel administrimi në SHA, administratorët emërohen nga:
- Asamblea e Përgjithshme me shumicë të thjeshtë;
 - Asamblea e Përgjithshme me shumicë të cilësuar;
 - Këshilli i administratorëve;
 - asnjë prej tyre.
76. Në shoqërinë kolektive, përgjegjësia e ortakut të ri që e fiton këtë cilësi në një shoqëri ekzistuese është :
- përgjegjesi për gjithë detyrimet e shoqërisë që nga momenti kur ortakut fiton këtë cilësi;
 - përgjegjesi për gjithë detyrimet e shoqërisë, përfshirë këtu dhe detyrimet që ekzistonin përpara se ortakut ta fitonte këtë cilësi;
 - sipas përcaktimeve të bëra në statut;
 - asnjë prej tyre.
77. Ortaku i një SHPK-je që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës në shoqëri ka të drejtë :
- ndalimin e cënimit dhe shpërblimin e dëmit brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit;
 - shpërblimin e dëmit brenda 12 muajve nga çasti i cënimit;
 - shpërblimin e dëmit brenda 6 muajve nga çasti i cënimit;
 - asnjë prej tyre.
78. Veprimet e kryera në tejkalim të objektivit të shoqërisë janë:
- gjithmonë të pavlefshme;
 - gjithmonë të detyrueshme për shoqërinë;
 - të detyrueshme, me përjashtim të konstatimit të dijenisë së të tretëve;
 - asnjë nga alternativat e mësipërme.

E DREJTË PUNE

79. Punëdhënësit detyrohen të bëjnë instruktive për:
- punëmarrësit të cilët janë të rinj në një vend pune;
 - punëmarrësit, pavarësisht ndryshimit të kushteve dhe vendit të punës;
 - punëmarrësit të cilët kryejnë të njëjtin proces pune, pavarësisht ndryshimeve teknologjike;
 - punëmarrësit ekzistues në ndërmarrje në mënyrë të përsëritur.
80. Paga që paguhet për pushimet vjetore, është:
- paga mesatare vjetore, për atë vit kalendarik;
 - paga që do të merrte sikur të ishte në punë;
 - paga, duke zbritur shtesat me karakter të përhershëm;
 - paga mesatare mujore për atë muaj kalendarik.



RUBRIKA VIII
PROCEDURË CIVILE DHE E DREJTË CIVILE
TEZA 24

81) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Librat e avokatëve, noterëve, përmbauesve, mjekëve, farmacistëve e të profesioneve të tjera që i mbajnë sipas dispozitave në fuqi, përbëjnë provë të plotë për sa shkruhet në to;
- b. Shkresa private përbën provë në favor të përpiluesit, pavarësisht se cili e paraqet atë si provë në gjykim;
- c. Shkresa private përbën provë në favor të përpiluesit edhe në qoftë se bëhet fjalë për librat e tregtarëve të mbajtura sipas Kodit Tregtar, vetëm në qoftë se atë e paraqet pala kundërshtarë;
- d. Shkresa që është përpiluar nga një person zyrtar, që nuk ka qenë kompetent ose që nuk është sipas formës së caktuar ka fuqinë provuese të një shkrese të thjeshtë.

82) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Kur duhet të dorëzohen disa pasuri të veçanta, mund të lëshohen urdhëra ekzekutimi të veçantë, duke shënuar se cila pjesë e titullit duhet të ekzekutohet për çdo urdhër ekzekutimi;
- b. Kur titulli ekzekutiv është dhënë në dobi të disa personave, nuk mund të lëshohen urdhëra ekzekutimi të veçantë;
- c. Kur titulli ekzekutiv është dhënë kundër të disa personave, nuk mund të lëshohen urdhëra ekzekutimi të veçantë.

83) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, vetëm kur ai ka mbushur moshën 16 vjeç;
- b. Gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, vetëm kur ai ka mbushur moshën 14 vjeç;
- c. Gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, vetëm kur ai ka mbushur moshën 10 vjeç;
- d. Gjykata, kur e çmon të nevojshme, mund të vendosë për emërimin e kujdestarit, pa qenë nevoja të pyesë edhe të miturin.

84) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, paguhet taksë 3% e vlerës së objektit të padisë;
- b. Për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, paguhet taksë 10% e vlerës së objektit të padisë;
- c. Për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, paguhet tarifë gjyqësore 3% e vlerës së objektit të padisë;
- d. Për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, paguhet tarifë gjyqësore 1% e vlerës së objektit të padisë.

85) Gjeni fjalinë e saktë:

- a. Prova me dëshmitarë lejohet në çdo rast;
- b. Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet përveç kur ligji për vlefshmërinë e një veprimi juridik kërkon shkresë;
- c. Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë;
- d. Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë.



TEZA 24

86. Rrethoni alternativën e gabuar:

- a. Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit.
- b. Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura, në cdo rast detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.
- c. Pronari i një ndërtese ose i një ndërtimi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga të metat e cdo ves tjetër që ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre.

87. Rrethoni përgjigjen e saktë:

- a. Cdo mangësi në ekzekutimin e detyrimit e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar kreditori, përveçse kur debitori provon që mospërbushja nuk ka ardhur për fajin e tij.
- b. Cdo mangësi në ekzekutimin e detyrimit e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar kreditori, edhe sikur debitori të provojë që mospërbushja nuk ka ardhur për fajin e tij.
- c. Cdo mangësi në ekzekutimin e detyrimit e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar kreditori, përveçse kur debitori do të përdorte punën e të tretëve dhe mospërbushja është shkaktuar prej tyre.

88. Rrethoni përgjigjen e saktë:


- a. Personat juridike nuk mund të jenë anëtarë të shoqatës.
- b. Për krijimin e shoqatës, mjafton që të bien dakord të paktën pesë individë.
- c. Vetëm individët mund të jenë anëtarë të shoqatës.

89. Rrethoni përgjigjen e saktë:

- a. Poseduesi me keqbesim ka të drejtë të kërkojë edhe pagimin e shpenzimeve të nevojshme që ka bërë për sendin.
- b. Poseduesi me keqbesim nuk ka të drejtë të kërkojë vetëm pagimin e shpenzimeve të nevojshme që ka bërë për sendin.
- c. Poseduesi me keqbesim ka të drejtë të kërkojë vetëm pagimin e shpenzimeve të nevojshme që ka bërë për sendin.

90. Rrethoni alternativën e gabuar:

- a. Nuk mund të hiqet dore nga trashëgimi, kur gjatë afatit tremujor, trashëgimtari me veprimet e tij është sjellë si trashëgimtar.
- b. Trashëgimtarët që kanë hequr ose fshehur sende nga trashëgimi, humbasin të drejtën e heqjes dorë dhe mbeten trashëgimtarë edhe sikur të kenë deklaruar heqjen dorë nga trashëgimi.
- c. Nuk mund të hiqet dore nga trashëgimi, kur gjatë afatit një mujor, trashëgimtari me veprimet e tij është sjellë si trashëgimtar.



RUBRIKA IX
E DREJTË PENALE – PROCEDURË PENALE
TEZA Nr. 15

91. **Pyetja e dëshmitarit në moshën 14-18 vjeç kryhet nga:**
- a) kryetari i trupit gjykues, mbi bazën e pyetjeve dhe kundërshtimeve të palëve;
 - b) vetëm nga prokurori;
 - c) vetëm nga mbrojtësi i të pandehurit;
 - d) gjithmonë nga prokurori dhe nga pala që ka kërkuar pyetjen;
 - e) vetëm nga psikologu, i autorizuar nga gjykata.
92. **2. Përgjimi i bisedimeve ose komunikimeve lejohet kur hetohet për krimin e vrasjes, në rastet kur:**
- a) vrasja kryhet me dashje;
 - b) asnjëherë;
 - c) gjithmonë;
 - d) edhe në rastin e vrasjes nga pakujdesia;
 - e) në rastin d), por me autorizim të prokurorit.
93. **Nuk janë të detyruar të dëshmojnë:**
- a) bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore;
 - b) viktimi e veprës penale;
 - c) personi që bashkëjeton me të pandehurin;
 - d) a+c;
 - e) asnjëri prej personave të mësipërm.
94. **Viktima e veprës penale ka të drejtë të kërkojë:**
- a) vetëm ndjekjen penale të fajtorit;
 - b) masën e dënimit që duhet të marrë i pandehuri
 - c) vetëm shpërblimin e dëmit të shkaktuar;
 - d) a) + c);
 - e) caktimin e një mase sigurimi për të pandehurin.
95. **Regjistrimi i fshehtë filmik në vende publike lejohet:**
- a) për çdo veprë penale të kryer me dashje, me kusht që veprimi të lejohet nga gjykata;
 - b) për vepra penale të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim, në maksimum, jo më pak se tre vjet;
 - c) për veprat penale të kryera nga pakujdesia, për të cilat lejohet arrestimi në flagrancë;
 - d) për vepra penale të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim, në maksimum, jo më pak se shtatë vjet;
 - e) për çdo krim që kryhet me përdorimin e teknologjive informatike ose telematike.



96. Në teorinë e të drejtës penale, tentativa konsiderohet e metë, në rastin kur:

- a) Personi ka përdorur mjete të cilat i kanë patur cilësitë e duhura për të arritur rezultatin e dëshiruar, i cili nuk ka ardhur për shkak të pavarura nga vullneti i tij;
- b) Personi ndonëse ka sulmuar drejtëpërdrejt objektin e veprës penale, nuk i ka kryer të gjitha veprimet e domosdoshme për ardhjen e pasojës së dëshiruar;
- c) Personi ndonëse ka ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e veprës penale, ka përdorur sende të cilat nuk i kanë patur cilësitë e duhura për shkaktimin e pasojës kriminale të dëshiruar.

97. I dënuari që është vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një ose disa detyrime:

- a) Riparimin e dëmit civil të shkaktuar;
- b) Të mos frekuentojë lokale ku shërbejnë pije alkoolike;
- c) Të mos kryerjë vepra të tjera penale po aq të rëndë apo më të rëndë se, ajo për të cilën është dënuar;
- d) a+b;
- e) a+b+c

98. Në kategorinë e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën e ekonomisë bëjnë pjesë edhe:

- a) Vepra penale e "Falsifikimit të akteve të gjendjes civile";
- b) Vepra penale e "Fshehjes së gjendjes së falimentimit";
- c) Vepra penale e "Paracaktimit të rezultateve në garat sportive";
- d) Të gjitha alternativat janë të sakta;
- e) Asnjë nga alternativat nuk është e saktë.

99. Subjekt i veprës penale "Moskallëzim krimi" mund të jetë:

- a) Çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, i cili ka kryer ose është duke kryer një vepër penale;
- b) Çdo person që për shkak të funksionit që ka, detyrohet me ligj të bëjë kallëzimin e një krimi apo kundravajtje të kryer ose që është duke u kryer;
- c) Çdo person i përgjegjshëm para ligjit, i cili ka dijeni për kryerjen e një krimi, me përjashtim të të paralindurve ose të paslidurve.

100. Identifikoni alternativën e saktë:

- a) Kundravajtja penale "Organizmi i lotarive të palejuara" kërkon si element të domosdoshëm jo vetëm veprimin ose mosveprimin e kundraligjshëm, por edhe ardhjen e ndonjë pasoje kriminale;
- b) Subjekti në kryerjen e veprës penale "Paracaktimi i rezultateve në garat sportive" është një subjekt i posaçëm – personat me funksione të caktuara në lidhje me garat sportive;
- c) Nga ana subjektive, vepra penale "Shtreëmbërimi i konkurrencës në garat sportive", kryhet me dashje direkte ose nga pakujdesia në formën e neglizhencës;
- d) Të gjitha alternativat janë të sakta;
- e) Asnjë nga alternativat nuk është e saktë.

